



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.20/2011

Prishtinë, më 07.07.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Hashim Dëshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić.

Pjesëmarrës të tjerë: Bill Klaëonn dhe Haxhi Gashi - USAID/Delotte; Besim Zeqiri- ICO; Natyra Kasumaj - KDI dhe Sanije Berisha- OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-33 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, mbi çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-35 për Riorganizimin e ndermarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;
5. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente të Projektligjit nr.04/L-026 për markat tregtare;
6. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente të Projektligjit nr.04/L-028 për dizajnin industrial;
7. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente të Projektligjit nr.04/L-029 për patenta;
8. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me dhjetë (10) Vota Për dhe Një (1) Kundër.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-33 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, mbi çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

Kryetari – theksoj se do të duhej ti miratonim këto Projektligje ne parim dhe të caktojmë një Grup punues për të tri Projektligjet për shkak të natyrës së lëndës që i përbëjnë këto Projektligje. Njiherit propozoi që të jenë të përfshira të gjitha grupet parlamentare në Grup punues.

Sala Berisha – Shala – propozoi që kryetari i Komisionit të jetë raportues i këtij Grupi punues.

Teuta Sahatqitu – propozoi Lutfi Zharkun si anëtarë të Grupit punues.

Fikrim Damka – propozoi Biserka Kostiq për anëtarë të Grupit punues.

Pas debatit, Komisioni dhjetë (10) Vota Për dhe Një (1) Apstenim nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.04/L-33 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, mbi çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Dhe Kuvendit i parashtrohet këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-33 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, mbi çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

2. Arsytimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjeve; Projektligji nr.04/L-33 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, mbi çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit; nr.04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit; nr.04/L-35 për Riorganizimin e ndermarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Zenun Pajaziti raportues, Fikrim Damka, Visar Ymeri, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq anëtarë;*
- 3. Grupi punues në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

Kryetari – bëri thirrje që edhe ky Projektligj të miratohet në parim dhe Grupi punues tanime i caktuar të punoj që sa më shpejtë të hartoi raportin me amendamente.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Dhe Kuvendit i parashtrohet këtë

R e k o m a n d i m

- 1. Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.*

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-35 për Riorganizimin e ndermarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;

Kryetari – përsëriti thirrjen e njëjtë sikurse për dy Projektligjet respektibile.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.04/L-35 për Riorganizimin e ndermarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Dhe Kuvendit i parashtrohet këtë

R e k o m a n d i m

- 1. Të miratohet në parim, Projektligji nr.04/L-35 për Riorganizimin e ndermarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.*
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.*

5. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-026 për markat tregtare;

Kryetari – si raportues i këtij Projektligji paraqiti amendamentet për shërytim dhe miratim, si vijon: **Amendamenti 1** Neni 3, pas paragrafit 1.18 shtohen edhe dy paragrafe 1.19 dhe 1.20; **Amendamenti 2** Neni 15, paragrafi 3, fjala “çertifikuar” zëvendësohet me “vertetuar”; **Amendamenti 3** Neni 17, paragrafi 4, fjalia “gazeta” zëvendësohet me “buletin”; **Amendamenti 4** Neni 20, paragrafi 1, togfjalshi “Kur marka tregtare” zëvendësohet me “Kur pronari i markës tregtare”; **Amendamenti 5** Neni 29, paragrafi 2, fshihen fjalet “në gjuhën shqipe dhe serbe”; **Amendamenti 6** Neni 30, pas paragrafit 5 shtohen edhe dy paragraf 6 dhe 7; **Amendamenti 7** Neni 33, paragrafi 1, lidhëza “do” zëvendësohet me “duhet”; **Amendamenti 8** Neni 35, paragrafi 6, riformuloht; **Amendamenti 9** Numri i nenit 46 “Heqja dorë” në KREU VIII, behet me numër 47. Nenet në vazhdim rinumërohen; **Amendamenti 10** Neni 70, paragrafi 3 fshihet; **Amendamenti 11** Neni 76, paragrafi 5, fshihet fjalia “të dorëzohen”; **Amendamenti 12** Neni 111, paragrafi 3, riformulohet.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohen Amendamentet për Projektligjin nr.04/L-026 për markat tregtare dhe u dërgohet për shqyrtim të mëtutjeshme Komisioneve të përhershme.

6. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-028 për dizajnin industrial;

Kryetari – ia dha fjalën deputetes Biserka Kostić si raportuese e këtij Projektligji që ti prezantoi amendamentet.

Biserka Kostič – paraqiti propozim-amendamentet për shqyrtim dhe miratim si vijon: **Amendamenti 1** Neni 1 ndryshohet; **Amendamenti 2** Neni 3, pas nënparagrafit 1.16 shtohen nënparagrafet 1.17; 1.18; 1.19; 1.20 dhe 1.21; **Amendamenti 3** Neni 5, titullohet si vijon: Mbrojtja e dizajnit industrial, Paragrafi 3, teksti “normal sipas paragrafit 2” zëvendësohet me fjalën “sipas”; **Amendamenti 4** Neni 8, nenparagrafi 3.2 para tekstit “data e përparësisë” shtohet lidhëza “nga”; **Amendamenti 5** Neni 21 fshihet; **Amendamenti 6** Neni 22 fshihet; **Amendamenti 7** Neni 69, paragrafi 3 fshihet; **Amendamenti 8** Neni 77, ndryshohet titulli si vijon: “Procedurat e përsheptuara”, ndërsa paragrafi 2 dhe 4 te këtij neni fshihen; **Amendamenti 9** Neni 84, paragrafi 4, fjala “Ministria” zëvendësohet me “Ministri” dhe këtij paragrafi i shtohet teksti si vijon: “ne afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh, nga hyrja ne fuqi e këtij ligji”.

Pas debatiti Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohen Amendamentet për Projektligjin nr.04/L-028 për dizajnin industrial dhe u dërgohet për shqyrtim të mëtutjeshme Komisioneve të përhershme.

7. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-029 për patenta;

Kryetari – ia dha fjalën deputetes Teuta Sahatqija si raportuese e këtij Projektligji që ti prezantoi amendamentet.

Teuta Sahatqija - paraqiti propozim-amendamentet për shqyrtim dhe miratim si vijon: **Amendamenti 1** Neni 1 ndryshohet; **Amendamenti 2** Neni 2, pas nënparagrafit 1.14 shtohen nënparagrafet 1.15; 1.16; 1.17 dhe 1.18; **Amendamenti 3** Neni 3 titullohet si vijon: “E drejta për të aplikuar”. Dhe shtohet një paragrafi si paragrafi 1; **Amendamenti 4** Neni 24, paragrafi 3 ndryshohet; **Amendamenti 5** Neni 29, togfjalëshi “Certifikata për Mbrojtje Plotësuese” zëvendësohet me “Certifikata suplementare”; **Amendamenti 6** Neni 35, fshihet paragrafi 4; **Amendamenti 7** Neni 43, paragrafi 1, togfjalëshi “për vendimin e saj final” zëvendësohet me “më vendimin”; **Amendamenti 8** Neni 46, titullohet si vijon: “Importimi i sasisë së vogël”; **Amendamenti 9** Kreu XII i ndryshohet titulli si vijon: “CERTIFIKATA SUPLEMENTARE PËR MBORJTJEN E PRODUKTEVE FARMACEUTIKE DHE PRODUKTEVE BIMORE”; **Amendamenti 10** Neni 131 i ndryshohet titulli si vijon: “Zbatimi i dispozitave te veçanta dhe nxjerrja e akteve nënligjore” dhe shtohet një paragraf i ri si paragrafi 2.

Pas debatiti Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohen Amendamentet për Projektligjin nr.04/L-029 për patenta dhe u dërgohet për shqyrtim të mëtutjeshme Komisioneve të përhershme.

8. Të ndryshme;

a) Spastrimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë e brendshme;

Kryetari – kërkoi nga deputetët që të nxirret një vendim në mënyrë që ti lejohet Departamentit ligjor që për shkak të referencave dhe disa detajeve teknike të bëjë të mundur spastrimin e ligjit. Potenco i se është fjala për “lejën e punës” e cila duhet të fshihet në tërë tekstin e ligjit për shkak se ai ka qenë qëllimi i ligjit.

Lutfi Zharku – theksoj se kjo nuk është çështje krejt teknike sepse kam vërejtur dhe edhe me herët ju kam bërë më dije se projektligji ka mjaft referenca të gabuara dhe jokonsistente njëra me tjetrën. Sepse në disa raste fshihet leja e punës e në disa raste nuk është fshirë.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Ngarkohet Departamenti ligjor i Kuvendit të Kosovës, që në spastrimin e Projektligjit nr. nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme, të harmonizoj referencat me qëllimin e Projektligjit, respektivisht me Amendamentin 3 në të cilën duhet të jete teksti: në tërë tekstin e Ligjit të fshihen fjalitë “leja e punës”.

b) Monitorimi i Agjencioneve të pavarura;

Kryetari – njoftoi deputetët së në muajin korrik do të fillojmë më vizitat zyrtare si formë të monitorimit të Agjencioneve të pavarura.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit